Fillon projekti i përbashkët me Sllovenině

Zëvendës shefi i misionit Aggeler, bashkë me zëvendës kryeministrin dhe ministrin për finansa Stavreski dhe ambasadorin slloven, mbajtën fjalim me rastin e fillimit të projektit të ri të USAID "Trajnim i revizorëve të brendshëm në sektorin publik" (TIAPS). TIAPS finansohet nga "Fondi për sfidat e donatorëve potencial", program unik i dizejnuar për të intensifikuar partneritetet e ndihmës së jashtme të Shteteve të Bashkuara me qeveritë më të reja donatore nga shtetet e Evropës Qëndrore dhe Lindore. Nëpërmjet të programit të Fondit për sfida, qeveritë e Shteteve të Bashkuara dhe të Sllovenisë do ti ndajnë në mënyrë të barabartë shpenzimet e projektit dhe do të koordinojnë prej së afërmi mbikqyrjen e projektit. Ky projekt është programi i parë i çertifikuar në Maqedoni që përqëndrohet në auditimin e performancës dhe të finansave në sektorin publik. Projekti do të trajnon 80 revizorë të brendshëm të sektorit publik konform standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të BE.

Foto: Zëvendës shefi i misionit Aggeler mban fjalim me rastin e fillimit të projektit të ri të USAID "Trajnim i revizorëve të brendshëm në sektorin publik" (TIAPS).

Str. "Samoilova" Nr.21 1000 Skopje /Telephone (+389) (2) 310 2000, Fax (+389) (2) 310 2499 E-mail: EmbSkoWebM@mt.net.mk